



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË E ULET DHE TE MESME DREJTUESE  
(Përgjegjës)**

**Lloji i diplomës** Psikologji/Punë sociale/ administrim arsimit,

**Niveli i diplomës “Diplomë e Nivelit të Dytë”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicionëve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Mallakastër**, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për grupin e pozicioneve:

- Përgjegjës i çështjeve arsimore, *Spektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor* kategoria: **III-A**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**LEVIZJE PARALELE:**

**08.10.2018**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**NGRITJE NE DETYRE DHE PRANIM NË  
SHËRBIMIN CIVIL:**

**11.10.2018**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

### **Përshkrim i Përgjithshëm**

- **Përgjegjës i çështjeve arsimore, Sektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor** kategoria: **III-A**  
*Ndjek çështjet arsimore, koordinon me Zyrën Arismore, me drejtoritë e shkollave për çështjet arsimore*

#### **DETYRAT**

##### **Detyrat Kryesore**

- **Përgjegjës i çështjeve arsimore, Sektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor** kategoria: **III-A**

- A)Ndjek mbarëvajtjen e zhvillimit të aktivitetit parashkollor nga edukatorët në kopshte dhe çerdhe.
- B)Ndjek problematiken për kopshtet dhe çerdhet dhe e përcjell tek përgjegjësi i sektorit.
- C)Ndjek trajtimin e problematikes konkrete dhe informon përgjegjësin,
- D)Inspekton punën në institucionet e arsimit parashkollor dhe në çerdhet.
- E)Informon me shkrim çdo javë përgjegjësin e sektorit, në lidhje me problematiken.
- F)Paraqet planin javor/mujor dhe vjetor pranë përgjegjësit të sektorit.
- G)Krijon dosjen ligjore për çështjet e arsimit parashkollor.
- H)Ndjek çdo problematikë që ka lidhje me arsimin dhe që ligji e delegon tek pushteti vendor.

### **1. LËVIZJA PARALELE**

#### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët për të gjitha pozicionet duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

1. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori ;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

**-Për pozicionin Përgjegjës çështjeve arsimore, Sektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor** kategoria: **III-A**

1. Diplome Bachelor ,Diplomë e nivelit të dytë në Psikologji/Punë sociale/ administrim arsimi

#### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë ose dorazi në një zarf** të mbyllur, në zyrën e **Njesise se Menaxhimit të Burimeve Njërzore**, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.



5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore. (Dëshmi penaliteti dhe raport mjekesor).

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti brenda datës 08.10.2018..***

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **09/02/\_2018\_, Njësia** e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën e kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes e-mailit të paraqitur nga kandidati në dokumentacionin e aplikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore;" ;
2. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
3. Ligji 152/2013 për nëpunësin civil i ndryshuar
4. Ligj Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar Në Republikën E Shqipërisë
5. **LIGJ Nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik"**

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për pervojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**



- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

## 1.6

### DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Mallakastër**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve me punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer;
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”,
  - në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

## 2

### PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

## 2.1

### KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;



6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

**--Për pozicionin Përgjegjës i çështjeve arsimore, Sektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor**  
kategoria: **III-A**

1. Diplome Bachelor dhe diplome te nivelit te dyte në gjuhë Psikologji/Punë sociale/ administrim arsimit

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID); ;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;;
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës 11.10.2018... Dokumentacioni dorëzohet pranë Zyrës së Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër.***

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 21.10.2018 **NJBNJ** do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në stendën e informimit të publikut, **listën e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e ulet dhe te mesme drejtuese** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit., në rrugë elektronike nëpërmejt emailit. Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësine Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit te saj.

## **2.4**

### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**



## Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;
2. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
3. Ligji 152/2013 për nëpunësin civil i ndryshuar
4. Ligj Nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar Në Republikën E Shqipërisë
5. **LIGJ Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”**

## Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidateve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

**Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin

**-(një pozicione)** Përgjrgjës i çështjeve arsimore, *Spektori i Arsimit dhe Shëndetit Parësor* kategoria: **III-A**

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

**Komiteti i Përhershëm i Pranimit** brenda 24 (njëzet e katër) orëve, vendos në dispozicion listën e fituesve, Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, shpall listën e fituesve.

#### **Njoftimi do të bëhet:**

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në stendën e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.



Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në :

e-mail : mshehaj@[bashkiamallakaster](mailto:mshehaj@bashkiamallakaster.gov.al).gov.al

**NJESIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**BASHKIA MALLAKASTËR**

**MARJOLA SHEHAJ**

